

BSH-1  
H 31

ERVIN  
HATIBI

PERDITE  
SHOH  
QIELLIN

Poezi



BSH-L  
H 31

Ervin  
Hatibi

PERDITË SHOH QIELLIN  
LITERATURË SHKUPA

PËRDITË  
SHOH  
QIELLIN

poezi



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## PARATHËNIE

Autori i vjershave të këtij libri është tepër i ri, pesëmbëdhjetë vjeç. Është mosha kur ende nuk mund të bëhen parashikime për shkrimtarin. Nga të gjitha artet letërsia është ajo që i shkon më pak moshës fare të re. Dhe kjo është e kuptueshme: brenda një kohe të shkurtër trurit të shkrimtarit të ardhshëm i duhet të pësojë atë komplikim e modifikim të domosdoshëm për të qenë në gjendje të përballojë peshën e letërsisë. Këtë proces ky tru duhet ta kalojë në mënyrë të shëndetshme, pra të natyrshme, për të mos u traumatizuar ose deformuar nga pesha e tepërt. Vetëm pas disa vjetësh, kur procesi i adaptimit të jetë kryer, parashikimi për shkrimtarin do të bëhet përherë më i saktë.

Në rastin e këtij poeti fare të ri, edhe nëse nuk mund të parashikohet saktësisht se si do të

jetë rruga e tij, lartësitë që do të arrijë gjatë fluturimit poetik, gjerësia e vizionit, regjistrat e hapësirat e mendimit, një gjë është jashtë çdo dyshimi: libra si ky, ndonëse modestë në dukje, paralajmërojnë një klimë (meteo) të nesërime të bukur. Dhe këta lloj librash janë të rëndësishëm në radhë të parë për këtë. Në këtë të nesërme, ky autor i ri ka mundësi të shquhet mbi gjithë shokët, aq sa ka mundësi të mbetet midis tyre i barabartë, kjo gjithashtu s'ka shumë rëndësi për letërsinë. Për letërsinë është e rëndësishme që dikush, pavarësisht nga emri që ka, Ervin, Arđian, Meritë të fluturojë lart në mënyrë që të tjerët të synojnë ta ndjekin.

Koncepti «flijim» në letërsi e ante nuk është as romantik as i trilluar. E gjithë kjo arenë e mrekullueshme krijimtarie është veç të tjerash një arenë flijimi, ku shumë, për të mos thënë shumica, flijohen që të tjetër të ecin përpara. Në tryezën e punës, midis shumë dorëshkrimeve të dërguara nga të rinjtë, jo par një kompleks faji, ka qohë që mbaj vjershët e nxënësve të shkollës «Oso Kuka» të Shkodrës. Në qoftë se krahas emrit të Ervin Hatibit shënovaldy emëra të tjerë, ata nuk janë të rastit. Janë Arđian Marku e Merita Gruda, të kësaj shkollë, e bashkë me ta Neritana Kraja, Artan Mani e Flutura Haxhia. Dhe sa të tjerë duhet të ketë anembanë Shqipëria, sa Ilirë, Altinë, Mimoza, Genca etj, që shkruajnë, që mendojnë, që fshijnë rreshtat e shkruar për të shkruar më mirë.

Nuk i përmenda këta emra pér të vënë një shenjë barazimi midis tyre pér hir të «frymës kolektive», një nga veset e këqija të kritikës ske-matike, e cila është e prirur pérherë kundër individualiteteve. Ata dallohen padyshim nga njëri-tjetri në radhë të parë nga shkalla e talentit, dhe çdo trajtimi barabartë do të ishte zemër-ngushtësi dhe mospërfillje pér ta. I përmenda bashkarisht sepse në vjershat e tyre ka diçka të përbashkët, çuditërisht, mrekullisht të përbashkët, çka tregon se ata janë vërtet pjellë autentike e një kohe.

Kjo gjë e përbashkët e tyre, kjo bukuri e freski, ky ozon e ky spektër i veçantë, të shpërndara në shumë poetë të rinj, gjenden të dendë-suara më qartë në librin e Ervin Hatibit. Ai është i kohës, i singertë, kryeqytetas në kuptimin më të mirë të kësaj fjale, mençurisht naiv, pa komplekse, pa retorizëm, pa ekstazë, pa romantizëm malësor, pa modernomani ose veteranomani, së fundi pa asnjë shenjë mllefesh meskine të ardhshme, kjo sëmundje gërryese që pér fat të keq shfaqet aty-këtu te disa letrarë të sotëm.

Ka disa porta që duket sikur të çojnë drejt letërsisë por shumica e tyre nuk të çojnë askund. Qëllon që shkrimitarët e rinj zgjedhin portën e gabuar dhe atë zgjedhje të keqe, në qoftë se nuk e korrigojnë me kohë, e paguajnë shtrenjtë më pas. Në qoftë se një nga portat e gabuara është ajo e servilizmit ndaj letërsisë ekzistuese, po aq e prapë, në mos më tepër, është porta e

mllefit pa shkak kundër saj. Ka për fat të keq letrarë që hapat e parë në art përpiken t'i shqërojnë me një autoreklamë. Pa botuar mirë librat e parë ata, duke mos qenë aspak novatorë, rreken të përhapin legjendën e gjoja novatorizmit të tyre, të «paketueshëm» prej të atjerëve. I qepen kësaj legjende banale, duke diskredituar kështu një nga idetë më madhështore të krijimit artistik. Të tillë pseudonovatorë kthehen kështu në flori për konservatorizmin e për luftën e tij kundër shkrimittarëve novatorë të vërtetë. Sepse janë këta të fundit që paguajnë pasojat. Legjendëtjetë e kotë është ankimi i vazhdueshëm për luftën që gjoja u bëhet, në kohën kur askush nuk i lufton. Këtë abuzim të ri e paguajnë prapë shkrimittarët që pa të drejtë mund të luftohen vërtet, por që mbeten në hipe ngaqë gjithë vëmendja shkon tek ata që kanë ngritur alarmin e rremë.

Në letërsi nuk hyhet as me përulje as me ndjenjë revanshi, në letërsi hyhet vetëm me dashuri, në kuptimin e madh të fjalës, d.m.th. me atë dashuri që ka brenda gjithçka: edhe nderimin për artin e madh, edhe mohimin e së keqes, edhe synimin për të fluturuar më lart, gjithmonë për ta çuar më lart artin e popullit tënd e të njerëzimit mbarë.

Ndihet menjëherë që Ervin Hatibi e ka gjetur portën e mbarë për të hyrë në letërsi. Për libra ose më saktë për një valë të re shkrimittarësh të rinj ka nevojë të domosdoshme sot letër-

sia shqipe. Nuk është krijuar ndonjë bosh i ndjeshëm që kërkon ngutje për t'u mbushur, megjithatë ndihet nevoja për një ushqim më të shumtë e më të pasur shpirtëror.

Tani që letërsia e sotme socialiste shqipe ka gati gjysmë shekulli që ekziston, pa kurrfarë pretendimi për të bërë një periodizim të saj, mund të vihet re megjithatë se ka pasur tri valë shkrimtarësh që kanë ndjekur njëra-tjetrën. Vala e parë, që erdhi fill pas Çlirimit e me të cilën u bashkuan shkrimtarë që shkruanin edhe më parë, (për fat të keq jo më të shquarit), krijoj shtresën e parë të letërsisë së tanishme, me suksese por edhe me mungesa të ndjeshme. Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, në fillim të viteve '60, një valë e re shkrimtarësh hyri vrullshëm në letërsi bashkë me një epokë plot shqetësimë. Duhet thënë se megjithatë mjaft shkrimtarë, ndonëse mosha i bashkonte me këtë valë të re, vazhduan e vazhdojnë ende të kenë afinitet me letërsinë e valës së parë. Në mesin e viteve '70, pra përsëri pas pesëmbëdhjetë vjetësh, në letërsinë tonë nisi të vinte një valë e re. Për çudi, edhe këta më shumë se me valën paraardhëse, patën afinitet me valën e parë, çka shpjegon edhe një vizion jo të gjerë sa ç'duhet të botës dhe kufizime e mungesa të ngjashme me ato të fillimeve të letërsisë së re.

Jemi në fillim të viteve nëntëdhjetë (pra kanë kaluar prapë pesëmbëdhjetë vjet), veç kurrësi për një simetri kabalistike, por sepse ndihet vërtet nevoja, në letërsinë tonë pritet ardhja e

një vale të katërt. Si valë që do të mbyllë këtë shekull e do të kapërcejë në mijëvjeçarin e ri, shpresojmë se ajo do të ketë gjithçka të mirë që pati letërsia jonë gjer më sot, e do të lejë pas gjithçka të keqe të saj. Prandaj mirëseardhja për autorin e ri të këtij libri, le të jetë mirëseardhje për gjithë aradhën e re.

### **ISMAIL KADARE**

**Tiranë, verë 1989**

## PËRDITË SHOH QIELLIN

Unë e shoh përditë *qiellin*  
Dhe hahem me vete  
Si s'u bëra piktor.  
Unë e shoh përditë *qiellin*  
Herë të bukur, herë të egër si betejë  
E gjithherë madhështor.  
14 vjet rreshtë më ngjanë se e kam ndjekur  
Jetën e tij  
Dhe hahem me vete  
Si s'u bëra piktor, si?!  
Unë e shoh përditë *qiellin*  
E *qielli* më sheh përditë mua.

## FËMIJËRIA

PERDITE SHOH GELLIIN

C'është ky kalorës që fluturon?  
Ç'janë këto xixa patkonjsh si rrufe?  
Jam unë, një djalosh,  
Kam netë që udhëtoj,  
Po largohem, po iki,  
Mamuzet tërë gjak i kam,

Më ndjekin,

Oh, janë shumë.  
Muji, Robin Hudi, Tom Sojeri, Timuri,  
Ali Baba dhe dielli me sy e gojë,  
Që mbrëmjeve vizatoja.

Më ndjekin topi dhe zogjtë,  
Oh, kush s'më ndiqka,  
Qenka e vështirë, mjaft e vështirë o miq,  
T'u largoke nga fëmijëria.